

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. "Ibrahim Rugova", Godina e Re pranë Gardës së Republikës, Kati 2, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050,00 ALL
NUIS: K91811014B

VENDIM

I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
PLUS COMMUNICATION SH.A.

Sot, më datë 17 Tetor 2017, në orën 17:00, pranë selisë ligjore të Shoqërisë Plus Communication Sh.A., në Rr. Ibrahim Rugova, Godina e Re pranë Gardës së Republikës, kati 2, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje "Shoqëria"), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Janë të pranishëm:

1. **Alba – Trade Handels GmbH**, me seli ligjore në Schwarzenbegstraße 1-3, 1010 Vjenë (Austri), e përfaqësuar nga përfaqësuesi me autorizim Z. Kreshnik Dibra, shtetas shqiptar, lindur në Shkoder, më 22 prill 1982, me banim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 31,83% të kapitalit të Shoqërisë;
2. **Union Grup Sh.p.k.**, me seli ligjore në Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Ismail Qemali, nr. 32, kati 3, 1019, Tiranë, NUIS K61527801R, e përfaqësuar nga Z. Niko Leka, shtetas shqiptar, lindur më 31 mars 1961, në Tiranë, me banim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 19,99% të kapitalit të Shoqërisë;
3. **Znj. Vjollca Hoxha**, shtetase shqiptare, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, me vendbanim në Tiranë, përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë Znj. Xhejnsila Hako, shtetase shqiptare, lindur më 20 maj 1986, në Tiranë, me banim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 12,43% të kapitalit të Shoqërisë;
4. **Albanian Distribution & Development Sh.p.k.**, me seli ligjore në Rruga Dhaskal Tod'hri, nr. 35. Kashar, Tiranë, NUIS K21308001C, përfaqësuar nga administratori Z. Xhaferr Xhako, shtetas shqiptar, lindur në Kolonjë, më 1 janar 1964, me banim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 12,13% të kapitalit të Shoqërisë;
5. **Z. Genc Turku**, shtetas shqiptar, lindur më 11 shkurt 1966, në Tiranë, me banim në Tiranë, Rr. Myslym Shyri, nr. 54, në cilësinë e aksionarit zotërues i 4,05% të kapitalit të Shoqërisë i përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë . Niko Leka, shtetas shqiptar, lindur më 31 mars 1961, në Tiranë, me banim në Tiranë;
6. **Z. Bukurosh Stafa**, shtetas shqiptar, lindur më 26 korrik 1951, në Elbasan, me banim në Rr. Brigada e VIII, Tiranë; në cilësinë e aksionarit zotërues i 1,66% të kapitalit të Shoqërisë i përfaqësuar nga përfaqësuesi me prokurë . Niko Leka, shtetas shqiptar, lindur më 31 mars 1961, në Tiranë, me banim në Tiranë;
7. **Znj. Matilda Shehu**, shtetase shqiptare, lindur në Korçë, më 27 prill 1973, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,41% të kapitalit të Shoqërisë;
8. **Postë Telekomunikacioni i Kosovës**, me seli ligjore në Prishtinë, Kosovë, Dardania nr. 10.000, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Z. Arian Gashi, shtetas kosovar, lindur më 16 prill 1976, në Mitrovicë, me banim në Kosovë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,11 të kapitalit të Shoqërisë;
9. **Znj. Gentiana Gjermani**, shtetase shqiptar, lindur në Fier, më 2 maj 1975, me vendbanim në Tiranë, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,01% të kapitalit të Shoqërisë.

Lista e aksionarëve të pranishëm në Asamblenë e Përgjithshme i bashkëlidhet këtij procesverballi si shtojca A.

Me konsensusin e të pranishmëve, Z. Kreshnik Dibra merr përsipër drejtimin e mbledhjes dhe fton Z. Enklid Milaj, që është gjithashtu i pranishëm dhe pranon, të kryejë funksionin e Sekretarit.

K.D

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. "Ibrahim Rugova", Godina e Re pranë Gardës së Republikës, Kati 2, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050,00 ALL
NUIS: K91811014B

Kryetari, me ndihmen e Sekretarit, pasi verifikon identitetin dhe tagrat e te pranishmeve ne lidhje me pjesemarrjen ne kete Asamble, deklarone se Asambleja e Shoqërisë është mbledhur në thirrjen e dytë të saj, në përputhje me statutin, në vijim të thirrjes datë 19 shtator 2017 drejtuar aksionarëve të Shoqërisë për të diskutuar dhe vendosur mbi Rendin e Ditës si më poshtë vijon.

Rendi i ditës

1. **Çështje të rregullimit të tregut dhe marrëveshjet përkatëse;**
2. **Të tjera.**

Pasi konstaton

praninë e aksionarëve që përfaqësojnë 82,62% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, të paraqitur personalisht ose nëpërmjet prokurave të posaçme, Kryetari

deklarone

mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (këtëj e tutje "**Asambleja**") të rregullt dhe të aftë për të diskutuar e vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës në përputhje me nenin 12 të Statutit të Shoqërisë.

* * *

1. **Çështje të rregullimit të tregut dhe marrëveshjet përkatëse**

Asamblea me unanimitet:

VENDOS

- te miratoje Marreveshjen Per Zgjidhjen me Pajtim me Vodafon sh.a., si u paraqit dhe u depozitua nga organet kompetente ne kete Asamble te Pergjithshme dhe te autorizoj Administratoren e Shoqerise Znj. Matilda Shehu te nenshkruaje, ne emer dhe per llogari te Shoqerise, kontraten perkatese dhe cfaredolloj dokumenti tjetër (duke perfshire, por pa u kufizuar tek shtojcat e saj) dhe/ose te kryeje cfaredolloj veprimi tjetër qe mund te jete i nevojshem ose i pershtatshmen per lidhjen e kesaj kontrate, si dhe ekzekutimin dhe permbushjen e detyrimeve qe i burojne Shoqerise nga kjo kontrate.

- te miratoje Marreveshjen e Spektrit me Vodafon sh.a., si u paraqit dhe u depozitua nga organet kompetente ne kete Asamble te Pergjithshme dhe te autorizoj Administratoren e Shoqerise Znj. Matilda Shehu te nenshkruaje, ne emer dhe per llogari te Shoqerise, kontraten perkatese si dhe te nenshkruaje cfaredolloj dokumenti tjetër (duke perfshire, por pa u kufizuar tek shtojcat e saj) dhe/ose te kryeje cfaredolloj veprimi tjetër qe mund te jete i nevojshem ose i pershtatshmen per lidhjen e kesaj kontrate, si dhe ekzekutimin dhe permbushjen e detyrimeve qe i burojne Shoqerise nga kjo kontrate;

- te miratoje Marreveshjen e Spektrit me Telekom Albania sh.a., si u paraqit dhe u depozitua nga organet kompetente ne kete Asamble te Pergjithshme dhe te autorizoj Administratoren e Shoqerise Znj. Matilda Shehu te nenshkruaje, ne emer dhe per llogari te Shoqerise, kontraten perkatese si dhe te nenshkruaje cfaredolloj dokumenti tjetër (duke perfshire, por pa u kufizuar tek shtojcat e saj) dhe/ose te kryeje

K.D

PLUS COMMUNICATION SH.A.

**Selia Ligjore: Rr. "Ibrahim Rugova", Godina e Re pranë Gardës së Republikës, Kati 2, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050,00 ALL
NUIS: K91811014B**

cfaredolloj veprimi tjetër që mund të jetë i nevojshëm ose i pershtatshëm për lidhjen e kësaj kontrate, si dhe ekzekutimin dhe permbushjen e detyrimeve që i burojnë Shoqërisë nga kjo kontratë;

- të miratojë Marrëveshjen Për Zgjidhjen me Pajtim me Altelecom sh.a., si u paraqit dhe u depozitua në këtë Asamble të Pergjithshme dhe të autorizojë Administratoren e Shoqërisë Znj. Matilda Shehu të nënshkruajë, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, kontratën përkatëse si dhe të nënshkruajë cfaredolloj dokumenti tjetër (duke përfshirë, por pa u kufizuar tek shtojcat e saj) dhe/ose të kryejë cfaredolloj veprimi tjetër që mund të jetë i nevojshëm ose i pershtatshëm për lidhjen e kësaj kontrate, si dhe ekzekutimin dhe permbushjen e detyrimeve që i burojnë Shoqërisë nga kjo kontratë.

2. Të tjera

Asambleja me unanimitet:


- të autorizojë Këshillin e Administrimit që, duke filluar nga momenti i miratimit të kontratave të mesipërme nga AKEP, të marrë masat e nevojshme ose të pershtatshme, në lidhje me marrëdhëniet e punësimit dhe administrimit.

* * *


Duke qenë se nuk ka çështje të tjera për të diskutuar dhe duke qenë se askush nuk e kërkoi fjalën, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 19:00.

Dokumentet në vijim i bashkëlidhen këtij vendimi:

- Listë-prezenca e aksionarëve të pranishëm në Asamble.
- Autorizimet e Pjesëmarrjes.



Kryetari/ Kreshnik Dibra



Sekretari/ Enklid Milaj